REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E DOGANËS

# RAPORT VJETOR PËR PUNËN E DREJTORISË SË DOGANËS NË VITIN 2007

**Shkup,mars viti 2008**

REZYME

Drejtoria e doganave të Republikës së Maqedonisë është përqendruar në vendosjen e plotë kompatibil të sistemit doganor me atë të Unionit Evropian dhe me standardet e Organizatës Doganore Botërore. Në vitin 2007 Drejtoria e doganës (në tekstin e mëtutjeshëm:Drejtoria e doganës) në mënyrë intensive ka punuar në realizimin e planit nacional për miratimin e Acquis Communautatre,harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit dhe qasjen drejt konventave ndërkombëtare. Në fund të vitit 2007 Republika e Maqedonisë ka fituar statusin për konventat e përbashkëta transite të Komisionit Evropian.

Vitin 2007 e kanë shënuar aktivitetet intensive për përforcimin e mëtutjeshëm të kapacitetit institucional dhe administrativ të Drejtorisë së doganës,si dhe për lehtësimin dhe përshpejtimin e tregtisë,ku aksent është vendosur në arritjet e rezultateve konkrete në shkatërrimin e korrupsionit,ndalimin e tregtisë jolegale,importin,transitin e falsifikimeve dhe piraterive dhe zvogëlimin e shpenzimeve të operatorëve ekonomik. Ndihma nga jashtë në bazë bilaterale dhe multilaterale ka pasur kontribut të jashtëzakonshëm në forcimin e kapacitetit institucional dhe administrativ të Drejtorisë së doganës.

Në vitin 2007 ka filluar procesi i sjelljes dhe ndryshimi i akteve interne me të cilat rregullohet organizimi dhe proceset punuese në Drejtorinë e doganës,është realizuar programi gjithëpërfshirës për trajnime të punësuarve,janë përforcuar mekanizmat interne kontrolluese,janë zbatuar një numër i madh i procedurave hetuese dhe disiplinore të cilat kanë rezultuar me një numër të madh largime nga puna dhe aktgjykime penale,ndërsa njëkohësisht kanë filluar aktivitetet për rekonstruimin e plotë të përkrahjes informatike dhe komunikative dhe futjes e sistemit një sportel për procedurat importuese dhe eksportuese.

Rritja e angazhimit në zbatimin e ligjeve ka rezultuar me zbulimin dhe ndalimin e një numri të madh të tentimeve për mashtrim doganor,ku janë konfiskuar një sasi e madhe të mallrave,narkotikeve,armëve,dhe falsifikimeve,janë iniciuar disa qindra kallëzim dhe mijëra kallëzime kundërvajtje. Janë furnizuar katër aparate rëngën mobil për kontroll të kamionëve dhe kontejnerëve,ku bashkë me angazhimin e eksperteve doganor nga Unioni Evropian,paraqet bazë për arritjet e rezultateve në këtë segment në periudhën e ardhshme.

Me qëllim zvogëlimin e shpenzimeve të operatorëve ekonomik,në iniciativë të Drejtorisë së doganës në vitin 2007 është kryer zvogëlimi dhe eliminimi i taksave administrative dhe kompensimet për shërbime të ndryshme doganore,është futur mundësia për zvogëlimin dhe eliminimi i plotë i sigurisë së borxhit doganor potencial në bashkëpunim me shoqatën e biznesit janë larguar disa pengesa operative dhe normative me çka janë thjeshtëzuar procedurat doganore.

Në krahasim me vitin 2006,Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka paguar 28% të ardhura më të mëdha.

EUROINTEGRIMI

Me ndryshimet e ligjit doganor të Unionit Evropian të cilat janë shpallur në rregulloren e Unionit Evropian nr.648/05,në pjesën e parë të vitit 2007 janë përgatitur ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit doganor,të sjell nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në fillimin e vitit 2008,në të cilën është vendosur kornizë ligjore për sjelljen e konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik.

Duke pasur parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian sipas të cilave taksat administrative të cilat paguhen për procedura të caktuara doganore nuk janë në pajtueshmëri me legjislaturën Evropiane,në fillimin e vitit 2007 janë sjell ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për taksa administrative me të cilat taksat për marrjen e lejeve të ndryshme doganore nga shuma të rëndësishme (të cilat kanë arritur 60.000 denarë) kanë arritur në një shumë simbolike (300 deri 500 denarë).

Në drejtim të harmonizimit të mëtutjeshëm me Ascquis Communautaire,janë bërë ndryshimet e rregullores për llojin dhe shumën e kompensimeve doganore për shërbimet e bëra në procedurat doganore me të cilat janë anuluar kompensimet prej 40 euro për informacionin e detyrueshëm tarifor dhe kompensimin prej 65 euro për shqyrtimet laboratorike.

Në pajtim me programin nacional për harmonizimin e së drejtës të Unionit Evropian,Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjell rregullore për zbatimin e rregullave të Komisionit Evropian për shpërndarjen e mallrave të caktuar në nomenklaturën e kombinuar (Gazeta zyrtare e RM nr 76/2007). Rregullorja mundëson zbatimin direkt të rregullave vendimeve evropiane dhe harmonizimin e mëtutjeshëm të Legjislacionit maqedonas me legjislacionin e UE.

Me ndryshimet e Ligjit për taksa administrative janë eliminuar taksat për lëshimin e lejeve për hapjen e depove doganore,leje për procedurë doganore me efekt ekonomik ,leje për procedurë të thjeshtëzuar transite,leje për procedurën e thjeshtëzuar të deklarimit apo procedurë e doganimit lokal,si dhe për thjeshtëzimin në lidhje me tregimin e prejardhjes së mallit,për përdorimin e teknikës për përpunimin elektronik të të dhënave,për përdorimin e sistemit standard për ndryshimin në procedurën për eksport për fisnikërim,për zbatimin e formave të zakonshme me udhëheqjen në depot doganore,për depozitimin e mallit vendas në depo doganore,për mbartjen e mallin prej një depo doganore në tjetër,si dhe për nxjerrjen e përkohshme të mallit nga depoja doganore,për bartjen e të drejtave dhe detyrimeve prej një personi në tjetër të cilat dalin nga procedura doganore me efekt ekonomik,për miratimin e formës së propozuar të udhëheqjes së evidencës për mallin në zona të lira ekonomike ose depo të lira.

Në bazë të iniciativës të Drejtorisë së doganës deri tek Qeveria e Republikës së Maqedonisë për afrimin drejt Konventës për procedurë transiti të përbashkët ndërmjet

Bashkësisë ekonomike Evropiane dhe shtetet EFTA dhe Konventës për thjeshtëzimin e formaliteteve gjatë tregtisë me mall,në dhjetor 2007 Republika e Maqedonisë mori statusin vendi vëzhgues e komiteteve punuese të Komisionit Evropian. Nga fillimi i vitit 2008 Drejtoria e doganës ka filluar të marrë pjesë në mbledhjet e komiteteve punuese. Plotësimi i mëtutjeshëm i kushteve për qasjen tek këto konventa ndërkombëtare paraqet harmonizimin e legjislacionin nacional me legjislacionin e UE në fushën e transitit dhe lidhjen me sistemin e ri transit kompjuteristikë të UE që do të thotë edhe furnizimi i softuerit të ri për përpunimin e deklaratave doganore. Në këtë drejtim në vitin 2007 janë ndërmarr hapat në vijim:

- Është punuar projekti fishe ndërsa është siguruar përkrahja e eksperteve për miratimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e UE,është financuar nga fondet e IPA 2007. Tenderi për zgjedhje është shpallur nga ana e Komisionit Evropian në fillim të vitit 2008.
- Në maj 2007 ekspertet e drejtorisë gjenerale për dogana dhe tatime të Komisionit Evropian kanë bërë mision IT awareness në Drejtorinë e doganës. Misioni si prioritet kryesor e identifikojë vendimin e ri softuer të transitit nacional i cili do ti përkrah bazat e konfigurimit nacional të punës doganore me pranimin e plotë të legjislacionit dhe standardeve të UE ,si dhe sigurinë e lidhjes me sistemet e UE.
- Në shtator 2007 Agjencioni Evropian për rekonstruim ndërmor obligime që të siguron dhe të financon asistimin teknik për përpunimin e specifikimit teknik për përpunimin e vendimit softuer të ri nacional. AER e në fillimin e vitit 2008 e kreu procedurën për zgjedhjen e eksperteve. Drejtoria e doganës ka buxhet për financimin e përpunimin e vendimit softuer nacional transit.
- Është përgatitur projekti fishe dhe është siguruar përkrahja e eksperteve për përpunimin e specifikimit teknik për përpunimin e vendimit softuer për lidhjen e transitit nacional softuer me sistemet përkatëse të UE,të financuar nga fondet IPA 2007. Tenderi për zgjedhjen është shpallur në fillim të vitit 2008 nga ana e Komisionit Evropian.
- Është përgatitur projekti fishe dhe është siguruar përkrahja nga fondet IPA 2008 për financimin e përpunimit të vendimit softuer për lidhjen me vendimin nacional transit me sistemet përkatëse të UE.

> Duke pasur parasysh se deri në fund të vitit 2007 duheshe të ndërpritet puna dhe asistimi teknik i CAFAO-MAQ,Drejtoria e doganës në shkurt 2007 ka përgatitur dhe deri tek Delegacioni i Komisionit Evropian ka dorëzuar propozim projekt fishe për përkrahje nga ana e UE (nëpërmjet fondeve IPA ) me tre nënprojekte a) harmonizimi i legjislacionit doganor në Republikën e Maqedonisë me legjislacionin e UE,b)fillimi i kompjuterizimit të shërbimit doganor në drejtimin e përmirësimit të efikasitetit të punës doganore dhe ofrimit të kushteve më të mira drejt përdoruesve dhe c) përmirësimi i kapacitetit në luftën kundër mashtrimeve ,korrupsionit dhe kontrabandës me drogë. Të gjitha projektet janë pranuar dhe në vijim është realizimi i tyre.

Në fillim të vitit 2007,në iniciativë të Drejtorisë së doganës është kryer reolokacioni në programin CARDS me të cilën alokacioni për furnizimin e një skaneri rëntgen për kontroll të kamionëve dhe kontejnerëve është dedikuar për furnizimin e pajisjeve për laboratori doganore,pajisje për mbikëqyrje të pjesshëm të vendkalimeve kufitare,vetura për njësitë operative të Drejtorisë së doganës dhe pajisje për kryerjen e përkthimit simulantë.

Me qëllim të zhvillimit të laboratoris doganore,me kërkesë të Drejtorisë së doganës,ndërsa nën organizimin e misionit CAFAO-MAQ,në maj 2007 është realizuar vizitë e një eksperti Slloven për laboratori doganore,i cili ka kryer vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese,ka dhënë propozime për adaptimin e laboratorisë ekzistuese doganore dhe e ka përkrahur në tërësi iniciativën e Drejtorisë së doganës për ndërtimin e laboratorisë së re dhe bashkëkohore,në pajtim me standardet evropiane. Duke pasur parasysh rëndësinë e vendosjes së laboratorisë moderne,dhe dimenzionare doganore në rrjedhë janë aktivitetet për sigurinë e hapësirave përkatëse.

Në bazë të bisedimeve të realizuara dhe përgatitjeve ndërmjet Drejtorisë së doganës dhe Drejtorisë gjenerale për dogana dhe tatime të Komisionit Evropian,në Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikë së Maqedonisë dhe Bashkësisë Evropiane dhe vendet anëtare të saj,në protokollin për prejardhje janë kontraktuar ndryshimet në dispozitat për kumulim me të cilat përreth materialeve me prejardhje nga Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë,janë përfshirë edhe materiale me prejardhje nga vendet të përfshira në procesin për stabilizim dhe asociim të Unionit Evropian dhe materiale me prejardhje nga Turqia në të cilat ka të bëjë Vendimi nr 1/95 të Këshillit për asociim të BE dhe Turqisë (për prodhime industriale). Në tetor 2007 Komisioni Evropian ka sjell vendim për kyçjen e Republikës së Maqedonisë në sistemin Pan Evro-Mediteran të kumulimit diagonal të prejardhjes së mallit.

Me ftesë të Drejtorisë së doganës,ODB në qershor 2007 ka realizuar misionin diagnostik për përshtatshmërinë e Republikës së Maqedonisë me kornizën e standardeve për siguri dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare. Pastaj është kryer vlerësimi strategjik i aftësisë së Republikës së Maqedonisë për zbatimin e reformave dhe modernizimit,për sigurinë e këshillave për zbatimin e kornizës së standardeve për siguri dhe lehtësimin e tregtisë dhe për sigurinë e drejtimit strategjik për zbatimin e aktiviteteve të ardhshme. Si rezultat i zbatimit të misionit diagnostik,përfaqësuesit e ODB (anëtar të ekipit diagnostik) kanë punuar raport në të cilën është përpunuar analiza strategjike e mangësive(gap analysis),të gjendjes momentale si dhe rekomandimet për veprimin e ardhshëm në shikim të implementimit të kornizës së standardeve për siguri dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare (faza e parë). Në vitin 2008 pritet të realizohet faza e dytë,përkatësisht përkrahja e eksperteve nga ODB për përgatitjen e planit detal për realizimin e rekomandimeve nga faza e parë.

Në nëntor 2007 Drejtoria e doganës ka përgatitur iniciativë për qasje të Republikës së Maqedonisë drejt konventës së reviduar Kjoto për lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare me analizë detale të harmonizuara me standardet. Konventa e revidzuar Kjoto duhet të siguroj transparencë dhe parashikimet e procedurave doganore për pjesëmarrësit,veçanërisht për importuesit,eksportuesit,transportuesit dhe shpedicionet.

KAPACITETI INSTUTUCIONAL

Korniza juridike

Për shkak mundësisë të zbatimit së dispozitave nga Ligji doganor të cilat parashohin mundësi për zvogëlimin e shumës së garancive të cilat pronarët e lejeve doganore patjetër duhet ti dorëzojnë deri tek Drejtoria e doganës në emër të sigurimit të borxhit potencial doganor, në gjysmën e parë të vitit 2007 është ndryshuar dhe plotësuar rregullorja për zbatimin e Ligjit doganor (Gazeta zyrtare e RM nr 40/2007). Me ndryshimin e rregullores janë paraparë Kriteriumet transparente (ndër të cilat historinë financiare dhe tatimore të kompanisë,pronarëve) për zvogëlimin e shumës të garancive (edhe deri në 0%nga borxhi potencial doganor) të cilat tregohen me deklarata përkatëse dhe dokumentet të cilat duhet ti dorëzojnë pronarët e lejeve të procedurave të importit për fisnikërim dh deponim doganor. Është siguruar thjeshtësimi dhe shpejtimi i procedurës për pranimin e garancive,si dhe eliminimin e të drejtës diskrecionale të Drejtorisë së doganës në mënyrë të pamjaftueshme transparente që ta cakton lartësinë e shumës të garancisë bankare(në vend që të definohet shuma e garancisë bankare,limitohet shuma e borxhit potencial në raport të zbatimit të garancive bankare). Njëkohësisht,mundësia për përdorimin e të drejtës së garancisë bankare të zvogëluar,siguron zvogëlimi e shpenzimeve të operatorëve ekonomik për sigurimin e garancive bankare (hipoteka,provizione bankare).

Përreth asaj të përmendur më parë për futjen e konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik,ndryshimet e Ligjit doganor të përgatitur në vitin 2007 (të sjell nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në fillim të vitit 2008)përmbajnë edhe dispozita me të cilat po precizohet dhe thjeshtëzohen edhe Kriteriumet për sjelljen,ndryshimin dhe anulimin e vendimeve nga ana e Drejtorisë së doganës. Po futet definicioni për person me rrezik të madh ,ndërsa dispozitat për kundërvajtjet doganore janë harmonizuar me Ligjin nacional për kundërvajtje. Me këto ndryshime mundësohet veprimi transparent dhe i padyshimtë i Drejtorisë së doganës gjatë marrjes eventuale të lejeve dhe licencave të lëshuara më parë dhe ndërmarrja e plotë e kompetencave nga gjykatat rreth zbatimit të procedurave për bërjen e kundërvajtjeve doganore(dënime mandatar dhe gjobë).

Me qëllim sigurimin e implementimit identik të vendimit të Qeverisë të Republikë së Maqedonisë në të cilën janë shtuar prodhime të reja të cilat i nënshtrohen shkallës preferenciale prej 5% në vend të shkallës së deriatëhershme prej 18%,Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka bërë ndryshimin e udhëzimit për zbatimin e Ligjit për TVSH gjatë doganimit të mallrave,me të cilën shtohen prodhimet e reja të cilat i nënshtrohen shkallës preferenciale prej 5% në vend të shkallës së deriatëhershme prej 18%.

Në drejtim të thjeshtëzimit të formaliteteve doganore dhe procedurave doganore,Drejtoria e doganës e ka ndryshuar udhëzimin për borxh doganor ku e ka eliminuar parashtrimin e obliguar të formularit origjinal PP50 tek deklarata doganore si dëshmi për pagesën e bërë të të dhënave doganore dhe të dhënave tjera. Me këtë po përshpejtohet dhe thjeshtëzohet procedura e doganimit,sepse importuesit nuk humbin kohë dhe para për furnizimin dhe prezantimin në dokument të shkruara për pagesën e

bërë të të dhënave importuese,ndërsa si dëshmi për pagesën e të dhënave importuese,doganierët marrin të dhëna nëpërmjet sistemit informativ në formë elektronike.
Në shtator 2007 Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjell vendim për zbatimin e parakohshëm të protokollit drejt marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë nga njëra anë dhe Bashkësisë Evropiane dhe vendet e saja anëtare nga ana tjetër në dispozitat për kumulim të prejardhjes së mallit ku është mundësuar eliminimi i shpenzimeve për të dhënat importuese dhe rritjen e kunkurencës të prodhimeve maqedonase të prodhuara me materiale të përsëritura të importuara nga Turqia,posaçërisht tekstili,gjatë eksportit në UE.

Në drejtimin e shpejtimit dhe lehtësimit të procedurës doganore gjatë importit,me iniciativë të Drejtorisë së doganës është përgatitur propozim për ndryshimin e Ligjit për tregti i cili parasheh eliminimin e kontrollit të detyrueshëm të referimit të mallit dhe udhëzimet teknike si kusht për doganim importi(të cilën e kryen inspektorati tregtar Shtetëror)dhe bartjen e tij në qarkullimin e brendshëm,përkatësisht sipas procedurës të doganuar importuese. Propozimi parasheh edhe anulimin e detyrimeve të importuesve të aparateve elektrikë para procedurës të importit të dorëzojnë sertifikat për teknikë përshtatje-atest(të lëshuar nga institucioni për standardizim) para organit doganor. Me ndryshimet e propozuara kontrolli i mallit nga aspekti i sigurisë në tregun vendas do të kryhet pas procedurës të doganim të importit. Ndryshimet e parashtruara në Ligjin për tregti janë miratuar nga ana e Qeverisë së Republikë së Maqedonisë dhe pritet që të njëjtat të sillen nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Nga 1 janar 2008 filluan të zbatohen ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për rrugë publike,të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e llogaritjes dh pagimit të kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve publike. Me ndryshimet është thjeshtëzuar procedura për pagesën e kompensimit (si fazë në eliminimin e tij të plotë) dhe i njëjti paguhet nga organet doganore në kalimet kufitare në dalje nga Republika e Maqedonisë. Ky kompensim ka të bëjë me rrugët publike në Republikën e Maqedonisë me përjashtim të rrugëve publike për të cilin shfrytëzim paguhet taksë. Për shkak zbatimit të drejtë dhe uniform të Ligjit për rrugë publike,ndërsa me kërkesë nga Drejtoria e doganës Ministria e transportit dhe lidhjes në dhjetor 2007 ka përgatitur instruksione për zbatimin e nenit 8 nga Ligji për ndryshime dhe plotësim të Ligjit për rrugë publike,me të cilat sqarohet mënyra e llogarisë dhe pagesa e kompensimeve e automjeteve të huaja për shfrytëzimin e rrugëve publike.

Në vitin 2007 janë sjell ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Drejtorinë e doganës dhe Ligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale,me të cilat është kryer harmonizimi i plotë i tyre me dispozitat nga Ligji për kundërvajtje,në atë mënyrë që Drejtoria e doganës u bë kompetente për udhëheqjen e procedurës kundërvajtës pas bërjes së kundërvajtjeve doganore.

Në dhjetor 2007 Drejtoria e doganës ka sjell Udhëzime për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirave punuese ku malli në automjetet transportuese vendoset në këqyrje dhe kontrollohet nga ana e organeve doganore,me të cilën për herë të parë rregullohet statusi i terminaleve private doganore dhe operatorëve ekonomik u sigurohet kushte të njëjta minimale për zbatimin e mbikëqyrjes doganore.

Para sjelljes të kësaj urdhërese,është konsultuar gjerësisht bashkësia e biznesit,ndërsa veçanërisht mbajtësit ekzistues të terminaleve doganore.

KAPACITETI ADMINISTRATIV

Me qëllim rritjen e kapacitetit administrativ të Drejtorisë së doganës,Ministria e Financave lidhi marrëveshje dy vjetore (me mundësi për vazhdimin edhe për dy vjet plotësues ) me shtëpinë konsultonte të njohur ndërkombëtarisht për angazhimin e eksperteve nga UE për përparimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve informuese,punën e ekipeve mobile doganore,analiza e rrezikut,zbatimi i procedurave dhe allateve bashkëkohore. Këto ekspert doganor kanë filluar me punë në Drejtorinë e doganës në fund të vitit 2007.

Angazhimi i këtyre eksperteve parasheh largimin e aktiviteteve të përsëritura me donatorët e huaj bilateral dhe multilateral. Në këtë kontekst Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka filluar me organizimin e mbledhjeve kordinative të donatorëve në të cilën prezantohen projektet,përparimi dhe planet e përbashkëta. Në vitin 2007 janë organizuar dy mbledhje koordinative të donatorëve




Në vitin 2007 Drejtoria e doganës me firmën "Nuctech"nga Kina ka nënshkruar marrëveshje për furnizimin e katër sistemeve mobil rëntgen për kontroll të kamionëve dhe kontejnerëve. Në fund të vitit 2007 janë porositur dy skenerë mobil dhe ka filluar trajnimi intensiv i inspektorëve doganor. Skeneret duhet të kontribuojnë drejt rritjes së pagesës së të dhënave importuese,ndalimi i kontrabandës dhe importit të mallit të pa lejuar,si dhe shpejtimin e rrjedhjes së mallit.

Në tetor 2007 Drejtoria e doganës i ka ndërmarr kompetencat nga gjykatat për udhëheqjen e procedurave kundërvajtës,shqipton sanksione kundërvajtës dhe masa të veçanta kundërvajtës për bërjen e kundërvajtjeve doganore. Qëllimi është që procedurat kundërvajtës të zgjidhen më shpejt dhe më efikas në funksion të zvogëlimit të kundërvajtjeve doganore. Është formuar edhe repart i pjesshëm për kundërvajtje-Komisioni për vendosje sipas kundërvajtjes dhe janë sjell akte interne për mënyrën dhe procedurën e organeve doganore gjatë zbulimit të kundërvajtjeve doganore dhe lëshimit të thirrjes për pagesën e gjobës dhe urdhër arkëtimit,si dhe për formën dhe përmbajtjen e procesverbalit për kundërvajtje doganore,thirrjes për pagesën e gjobës dhe urdhër arkëtimit. Komisioni për vendosje sipas kundërvajtjeve ka filluar me punë në tetor 2007.

Në bazë të strategjisë së miratuar dhe autorizimeve nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka filluar me aktivitetet për sjelljen e

sistemit një sportel për procedurat importuese dhe eksportuese. Në bashkëpunim me organet qeveritare,institucionet,sektorin privat,dhe organizatat joqeveritare të cilat kanë marrë pjesë në procedurat importuese dhe eksportuese,është realizuar një shkallë e lartë e harmonizimit dhe standardizimit të dokumenteve të cilat përdoren në procedurën importuese,eksportuese dhe transit,si edhe në rregullat ligjore dhe nënligjore përkatëse. Në organizim të Drejtorisë së doganës janë furnizuar me pajisjet informatike të nevojshme (për t gjitha organet shtetërore dhe institucionet) dhe është në përfundim përpunimi i vendimit softuer. Në rrjedh janë trajnimet e personelit IT dhe testimi i sofverit.

Më 31 dhjetor 2007 ka përfunduar me punë Misioni UE CAFAO MAK në Republikën e Maqedonisë e cila siguronte ndihmë teknike për Drejtorinë e doganës ë drejtim të modernizimit dhe përparimit e veprimeve doganore në pajtim me standardet evropiane. Para përfundimit të punës, UE nëpërmjet CAFAO MAK i ka dhuruar donacion Drejtorisë së doganës pajisje kompjuteristike si dhe pajisje tjera IT dhe pesë makina.

Në bashkëpunim me CAFAO MAK në vitin 2007 është përgatitur akt për sjelljen e drejtë me personin përkohësisht të mbajtur apo të arrestuar. Në aktin janë sqaruar drejtë të gjitha veprimet që duhet ti ndërmarrin doganierët në vendkalimet kufitare,në njësitë doganore dhe veprimet të cilat i ndërmarrin inspektorët nga sektori për kontroll dhe hetim. Njëkohësisht,është përgatitur edhe doracak për zbatimin e drejtë të legjislacionit gjatë zbulimeve të veprave penale dhe kundërvajtjeve doganore.

Në dhjetor 2007 është instaluar versioni maqedonas të sistemit TRACKER për kontroll të mallit dhe janë bërë trajnime të punësuarve,me çka janë kryer përgatitjet për fillimin e zbatimit të këtij sistemi.

Në korrik 2007 Qeveria e SHBA,Drejtorisë së doganës i ka dhuruar pajisje për detektim dhe identifikimin e rrezatimit,detektor të specializuar për zbulimin e kontrabandës,detektor metalik,dhe allat dore,me të cilat do të mundësohet efikasitet më i madh në zbulimin e mallrave të palejuar dhe të rrezikshme. Qëllimi i donacionit është rritja e kapacitetit dhe pajisjes teknike të Drejtorisë së doganës për mbrojtjen e kufijve shtetëror nga kërcënimet e mundshme nga terrorizmi,krimit të organizuar dhe tregtisë së palejuar.

Drejtoria e doganës në vitin 2007 nga Komisioni Evropian ka marrë autorizim për qasje si lexues tek IILIAD (nëngrup të grupacionit të laboratorive evropiane doganore) si një nga kushtet për përparimin dhe lehtësimin e mënyrës së sigurimit të metodave standarde analitike sipas të cilave kryhen analizat për nevojat doganore.

INTGRITETI

Një nga qëllimet strategjike për krijimin e personelit punues të lartë profesional dhe të trajnuar mirë kryhet nëpërmjet trajnimeve dhe aftësimin profesional të nëpunësve doganor. Në vitin 2007 për çdo ditë janë mbajtur aktivitete të ndryshme për aftësimin profesional të nëpunësve doganor.

> Sipas programit vjetor për trajnime në vitin 2007 janë realizuar 171 (135 në vitin 2006) aktivitete në formë të trajnimeve,seminareve,prezantimeve. Në të kanë marrë pjesë gjithsejtë 2.322 (1.509 në vitin 2006) pjesëmarrës nga Drejtoria e doganës. Në mesatare çdo i punësuar ka ndjek nga 27 orë trajnime ose çdo doganier në vit ka humbë 4 ditë në trajnime

Në mars 2007 Drejtoria e doganës ka sjell strategji për trajnim dhe aftësimin profesional të nëpunësve doganor. Me strategjinë janë vendosur parimet themelore të politikës të trajnimeve dhe aftësimit profesional,ku veçanërisht janë theksuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë pjesëmarrësve në procesin e trajnimeve të lidhur me procesin e integritetit evropian. Janë propozuar mënyra dhe metoda të reja për realizimin e trajnimeve,siç janë mësimi elektronik dhe trajnime për grupe përkatëse të pjesëmarrësve me zbatimin e metodave interaktive të trajnimit.

> Trajnimet më të rëndësishme që janë realizuar në vitin 2007:
> - Kurs për mësimin e gjuhës Angleze në pajtim me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe sigurimin e kushteve për ndjekjen e dispozitave të Unionit Evropian.
> - Trajnim për bazat e punës për kontabilitet,
> - Trajnim për zbulimin e drogës dhe kontrollin rëntgen e automjeteve transportuese,
> - Trajnim për përmirësimin e integritetit,imazhin e nëpunësve doganor dhe lufta kundër korrupsionit,
> - Në bashkëpunim me asociimin SNB React për bashkëpunim ndërmjet bartësve të së drejtës,përfaqësuesve dhe institucioneve kompetente është organizuar trajnim për identifikimin e markave tregtare,
> - Trajnim për procedurën për fisnikërim,
> - Trajnim për vlerën doganore,
> - Punëtori me temë mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale,
> - Kurs për mësimin e gjuhës Frënge,
> - Trajnim për sigurinë e transportit të kontejnerëve,
> - Trajnim për zbulimin e rrezatimeve,
> - Seminar me temë ndalimi i korrupsionit,
> - Seminar për kontroll të eksportit të mallrave dh teknologjisë për përdorim të dyfishtë,
> - Trajnim për njohjen dhe zbulimin e dokumenteve të falsifikuara,
> - Trajnim për procedura të thjeshtëzuara gjatë importit dhe kryerja e kontrollit tek bartësit e lejeve.

Në bazë të strategjisë për trajnim në prill 2007 Drejtoria e doganës ka sjell Program për mësimin elektronik,si dhe program vjetor për trajnim për vitin 2007. Me mësimin elektronik është arritur proces i zgjerimit të mësimit apo dorëzimi i instruksioneve të mundshme për përdorimin e gjerë të resurseve në lokacioni të cilat janë të ndryshme nga klasat klasike,ndërtesa ose hapësira,deri tek klasat tjera,ndërtesa ose hapësira me përdorimin e videove,komunikimit kompjuteristikë apo multimedik ose kombinimi i këtyre me metodat tjera të dorëzimit tradicional.

Formatted: Bullets and Numbering

Në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka filluar të zbatoj trajnime për aftësimin profesional të nëpunëse të ri doganor,të bazuara në mentor. Në qershor 2007 janë sjell programe precize për trajnimin kryesore për vendet e punës " doganier sipëror"dhe "doganier". Me këto

programe detal janë caktuar orari dhe temat e trajnimeve kryesore i cili qëllim është që të ndihmojnë në aftësimin profesional e nëpunësve të ri doganor.
Në bashkëpunim edhe me përkrahjen financiare të USAID projektit për përmirësimin e rrethimit të pjesshëm,Drejtoria e doganës në vitin 2007 e ka përmirësuar fondin dokumentar me doracak dhe publikime të ODB dhe i ka përkthyer,shpallur dhe i ka dorëzuar tek çdo punëtor publikimet në vijim:Korniza e standardeve për sigurimin dhe lehtësimin e tregtisë globale,sqarimi i shkurtër e konventës së reviduar Kjoto dhe nocionet e teminave ndërkombëtare doganore.

Në vitin 2007 në shkurt është sjell akt intern për kontroll të aftësive punuese dhe procedurat për fillimin e punësimit me shpalljet publike në Drejtorinë e doganës. Me atë janë plotësuar kriteret nga konventat dhe rekomandimet e organizatës ndërkombëtare të punës,deklarata e reviduar Arusha të këshillit për bashkëpunim doganor,Ligji për Drejtorinë e doganës dhe Ligji për ndalimin e korrupsionit në punë,si dhe me standardet e UE. Me këtë akt Drejtoria e doganë për herë të parë siguron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët,sundimin e së drejtës,mbrojtja e integritetit,mundësinë minimale për korrupsion dh zvogëlimin e të drejtave diskrecionale. Zgjedhja dhe seleksionimi kryhet në bazë të kritereve dhe standardeve të caktuara më parë,me kontrollin e aftësive punuese në varshmëri nga kushtet e veçanta për vendin e punës,të cilën e kryhen komisioni i formuar i veçantë. Në bazë të këtij akti,në vitin 2007 janë realizuar procedurat për punësimin e 200 nëpunësve doganor.

Në vitin 2007 në maj është sjell akt intern për zbatimin e shpalljes interne për plotësimin e vendeve të lira pune në Drejtorinë e doganës. Kjo mënyrë e plotësimit të vendeve të lira pune iu jep mundësi të gjithë nëpunësve doganor për përparimin në karrierë të cilët i plotësojnë kushtet për vendin e punës. Procedurën e realizon komisioni i formuar. Në fund të muajit maj në vitin 2007 është shpallur shpallje e parë interne sipas rregullave të reja.




Fakulteti ekonomik në Shkup dhe Drejtoria e doganës në vitin 2007 kanë filluar me aktivitetet për formimin e qendrës regjionale për trajnim të ODB. Fakulteti ekonomik në Shkup dhe ODB kanë nënshkruar memorandum për bashkëpunim,ndërsa me përkrahjen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë deri tek ODB është dorëzuar iniciativa. Në rrjedh është përgatitja e elaboratit në të cilën ODB duhet të sjell vendim përfundimtar.

Në bazë të rekomandimeve nga misioni diagnostik të ODB dhe strategjisë për luftën kundër korrupsionit,Drejtoria e doganës në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Holandës dhe ndihmës financiare nga Ministria e financave të Holandës kanë punuar material reklamues (në shumë gjuhë :maqedonisht,shqip,anglisht,turqisht dhe frëngjisht) i cili përbëhet prej pllakateve,dhe tabela shpalljeje,me qëllim për promovimin e

mëtutjeshëm të linjës së hapur telefonike 197 për paraqitjen e kontrabandës dhe korrupsionit të doganës. Njëkohësisht në televizionin nacional maqedonas po emitohen spotet e linjës së hapur telefonike (197) për nxitjen e paraqitjes të një numri më të madh të qytetarëve.

Në muajin tetor në vitin 2007 është sjell instruksion operativ për sistemin e vlerësimit të punës të nëpunësve doganor,me qëllim për kontrollin dhe përparimin e njohjeve profesionale.

Në suaza të aktiviteteve për vendosjen e sistemeve për ndalimin e korrupsionit,në mars 2007 në bashkëpunim me ekspertet e angazhuar nga CAFAO MAK janë punuar kërkimet për vendosjen e Drejtorisë së doganës në prirjen me korrupsionin dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare.

Për zbatimin më efikas të qëllimeve strategjike për prevenim dhe ndalim të korrupsionit,Drejtoria e doganës në vitin 2007 e ka miratuar deklaratën e reviduar Arusha dhe ka sjell strategji për integritetin dhe luftës kundër korrupsionit të harmonizuar me qëllimin e deklaratës së reviduar Arusha,si dhe planit aksionar me afate për implementimin e qëllimeve të strategjisë.

Në tetor 2007 Drejtoria e doganës dhe organizata sindikale kanë nënshkruar Kodin e sjelljes në Drejtorinë e doganës. Në kodin janë caktuar parimet themelore të sjelljes dhe punës gjatë kryerjes së detyrave punuese:përgjegjësisë personale,respektimi i së drejtës,paanësi,raporti me palët,dhuratat,shpërblimet dhe lloj tjetër të fitimit,ikja e konflikt interesash,aktivitete politike,punët që kanë të bëjnë me para,besueshmëria dhe përdorimi i informatave zyrtare,përdorimi i mjeteve për punë dhe për legjitimim,rrethana punuese,sjellja në jetën private dhe përgjegjësia disiplinore.

> Në vitin 2007 janë realizuar 10 trajnime kundër korrupsionit në të cilën kanë marrë pjesë 220 nëpunës doganor,ndërsa njëkohësisht është zbatuar trajnimi i trajnuesve për shkatërrimin e korrupsionit .

Në suaza të aktiviteteve për vendosjen e sistemeve në luftën kundër korrupsionit,në vitin 2007 është vendosur evidencë e lëndëve penale kundër nëpunësve doganor të tanishëm dhe të mëparshëm dhe evidentimin e procedurave hetuese dhe disiplinore kundër nëpunësve doganor. Njëkohësisht,është imponuar praktika (e cila në vitin 2008 do të bëhet në procedura të shkuara) e hetimit të punës gjithëpërfshirëse e të punësuarve tek të cilët është vërtetuar keqpërdorimi i detyrës zyrtare,ngritja e kallëzimeve penale kundër të punësuarve të cilët me keqpërdorimin e detyrës zyrtare e kanë dëmtuar buxhetin,ngritja e kërkesës për dëmshpërblim me ndalim të dispozicionit me pronësi kundër të punësuarve të cilët e kanë dëmtuar buxhetin, njoftim i komisionit Shtetëror për ndalimin e korrupsionit për të punësuarit të cilët duhet të parashtrojnë fletë anketuese për gjendjen pasurore,njoftimi i Drejtorisë për të hyra publike për dyshimin e prejardhjes së pasurisë të punësuarve dhe shpallja e emrave e të punësuarve kundër të cilëve janë shqiptuar masa ndëshkuese,por edhe të shpërblyesve për rezultatet e veçanta në punë.

Me qëllim përforcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për luftën kundër korrupsionit,në fund të vitit 2007 është lidhur Memorandum për bashkëpunim me Komisionin Shtetëror për ndalimin e korrupsionit,Prokurorin publike

shtetërore,Drejtoria e të ardhurave,Entin Shtetëror për revizion,Këshillin gjyqësor,policin financiare,Drejtoria për ndalimin e larjes së parave dhe MPB.

| Zyrat doganore | Raporte zyrtare | |
|---|---|---|
| | 2007 | 2006 |
| Drejtoria e doganës | 2 | |
| Dogana e Shkupit | 10 | 16 |
| Dogana e Kumanovës | 1 | 1 |
| Dogana e Shtipit | 9 | 2 |
| Dogana e Manastirit | 6 | 2 |
| Dogana e Gjevgjelisë | 5 | 1 |
| **Gjithsejtë** | **33** | **22** |

Sektori për përgjegjësi profesionale në vitin 2007 ka realizuar 33 inspekcione të brendshme (në krahasim me 22 në vitin 2006) në bazë të së cilës janë ndërmarr procedurat e mëtutjeshme për largimin e parregullsive dhe sjelljen e procedurave për përcaktimin e përgjegjësisë për kryerësit. Në vitin 2007 Sektori për përgjegjësi profesionale ka realizuar 240 (në krahasim me vitin 2006 ku janë realizuar 70) hetime të brendshme në bazë të informacioneve të pranuara dhe ankesave për zbatimin jo përkatës të procedurave doganore nga ana e doganierëve dhe për keqpërdorimin e detyrës zyrtare,ku për 87 raste janë përgatitur shënime zyrtare,në 61 raste (në krahasim në vitin 2006 me 16) janë përgatitur informacione zyrtare,ndërsa në 92 raste janë përgatitur informacione në të cilat është vërtetuar përgjegjësi e doganierëve.

| Zyrat doganore | 2007 | 2006 |
|---|---|---|
| Dogana e Shkupit | 65 | 23 |
| Dogana e Kumanovës | 29 | 17 |
| Dogana e Shtipit | 27 | 14 |
| Dogana e Manastirit | 62 | 10 |
| Dogana e Gjevgjelisë | 57 | 7 |
| **Gjithsejtë** | **240** | **70** |

Në vitin 2007 janë sjell 89 procedura disiplinore (14 në vitin 2006)në të cilat për 20 raste janë shqiptuar dënime me para (8 raste në vitin 2006),për 38 raste janë shqiptuar dënime ndërprerje të marrëdhënies së punës (2 raste në 2006),ndërsa në 31 raste procedura është ndërprerë (4 raste në 2006). Në këtë vit në 12 raste është shqiptuar masa suspendim(një në vitin 2006),në 45 raste është shqiptuar masa zvogëlim i rrogës (7 raste në 206).

Në vitin 2007 Drejtoria e doganës deri tek MPB ka dorëzuar 12 lëndë për sigurimin e dëshmive në bazë të dyshimeve për bërjen e veprave penale keqpërdorim të detyrës zyrtare,në bazë të së cilës MPB deri tani tek prokuroria publike ka parashtruar 5 kallëzime penale kundër 6 nëpunësve doganor. Në vitin 2007 MPB kundër 12 nëpunësve doganor ka parashtruar kallëzime penale për pranimin e ryshfetit.

Në bashkëpunim me policinë financiare deri tek prokuroria publike janë parashtruar 4 kallëzime penale kundër 5 nëpunësve doganor.

Në dhjetor 2007 Drejtoria e doganës ka dorëzuar 3 kallëzime penale tek prokuroria publike për shkak dyshimeve të bazuara për bërjen e veprave penale keqpërdorim të detyrave zyrtare dhe autorizimeve në të cilën kanë marrë pjesë 10 nëpunës doganor.

Në Drejtorinë e doganës funksionon revizioni i brendshëm e cila kryen vlerësimin e sistemeve për kontroll të brendshëm,jep mendime dhe këshilla për përmirësimin e punës,ndihmon në realizimin e qëllimeve me zbatimin e qasjes sistematike dhe disiplinore të vlerësimit dhe përmirësimit të efikasitetit në procesin me drejtimin me rreziqet,kontrollet dhe udhëheqjen. Revizioni ka për detyrë edhe ta përforcon disiplinën financiare dhe ta mbron institucionin nga shpenzimet jo efikase të mjeteve financiare. Revizioni i brendshëm duhet ti dekurajoj procedurat të cilat shkojnë drejt mashtrimeve,të promovoj praktika të mira dhe të kontrollon se mekanizmat e

kontrollit të brendshëm ekzistojnë dhe funksionojnë mirë. Në vitin 2007 janë kryer 9 revizione për të cilat janë përpunuar (lëshuar)raporte revizore konkrete dhe për të njëjtët janë lëshuar 31 rekomandime për veprim. Nga ato numri i përgjithshëm i rekomandimeve të zbatuara është 18,7 pjesërisht të zbatuar,ndërsa 6 të pa zbatuara. Për rekomandimet e pa zbatuara është dhëna afat deri në fund të muajit mars të vitit të ardhshëm.

Organizimi dhe sistemi

Drejtoria e doganës në vitin 2007 i ka kryer funksionet nga Drejtoria qendrore në Shkup dhe pesë doganat regjionale:Shkup,Kumanovë,Shtip,Gjevgjeli, dhe Manastir të cilat në bazë njëjtë janë implementuar politika,ligjet,dispozitat,urdhëresat dhe procedurat doganore nëpërmjet njësive doganore të brendshme dhe kufitare.




Në mars 2007 Drejtoria e doganës e ka mbartur doganimin e mallit të importuar nga terminali privat doganor në Gjevgjeli në terminalin shtetëror në vendkalimin kufitar Bogorodicë,i ndërtuar disa vite më parë por deri tani i pa përdorur. Me këtë u përshpejtua procedura doganore,u zvogëluan shpenzimet e biznesit dhe është zvogëluar tranzitimi i mallit të pa doganuar nëpërmjet Republikës së Maqedonisë.

Përreth kësaj,në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka ndalur punën në terminalet e brendshme doganore në Ohër,Milladinovcë,dhe Feni,ndërsa njëkohësisht ka hapur njësi doganore në zonën ekonomike Bunarxhikë në Shkup.

Me këto ndryshime,në fund të vitit 2007 funksionet e Drejtorisë së doganës kryhen në 37 njësi doganore,nga të cilat 18 në kalime kufitare(Bllacë,Jazhincë,Aeroport Shkup-qarkullimi i udhëtarëve,Mexhitli,Qafëthanë,Stenje,Bllato,Shën Naum,Aeroport Ohër,Gjevgjeli,Bogorodicë,Dojran,Tabanoc-autostradë,Tabanoc-stacioni hekurudhor,Pelincë,Deve Bair,Dellçevë,dhe Novo Sellë) dhe në 19 njësi doganore në brendësinë e Republikës së Maqedonisë (Shkup,Shkup-import,Shkup-eksport,Aeroport Shkup-për mallra,Zona e lirë Shkup,Posta Shkup,Vollkovë,Trubarevë,Tetovë,Kumanovë,Manastir,Posta Manastir,Prilep,Strugë,Kavadari,Strumicë,Shtip dhe Veles.

Me qëllim standardizimin dhe përmirësimin e funksionimit të vendkalimeve kufitare,në nëntor 2007 Ministria e Financave dhe Drejtoria e doganës kanë përgatitur plan detal për aktivitetet sipas bartësve dhe ndryshimet e projektit të Ligjit për Drejtorinë e doganës,në bazë të së cilës Drejtoria e doganës duhet ta marrë të udhëheqë me objektet në kalimet kufitare nga NP për udhëheqjen me hapësirat banesore dhe afariste.

Në vitin 2007 aksent të veçantë është vendosur në zhvillimin e përkrahjes aplikative të proceseve në Drejtorinë e doganës:

- Është përpunuar aplikimi për punën e depove me çka do të arrihet efikasitet më i madh në përdorimin dhe kursimin e materialeve;
- Është përpunuar kërkues i lajmeve nga mediet i cili mundëson marrjen e informatave relevante nga mediet vendase,regjionale dhe botërore në kohë reale.
- Është vendosur bazë detale elektronike e të dhënave për kallëzime penale të cilat Drejtoria e doganës i ka dorëzuar tek prokuroria publike.
- Është akomoduar softveri për evidentimin e garancive bankare dhe është sjell sistemi për ndjekjen e garancive,
- Ka filluar implementimi i një komponentë nga projekti "Sistemi transit i ri për këmbimin e porosive elektronike NTSREP". Ka përfunduar testimi i saj dhe është vendosur në provë tek të gjitha njësitë doganore.
- Në pjesën e afrimit tek standardet e sistemit për transit të përbashkët të UE,ka përparuar domeni nacional për transit,me migrimin e të dhënave për evidentimin e daljes së mallrave nga Republika e Maqedonisë në procedurën e transitit dhe eksportit,nga platforma e vjetër e bazave të të dhënave Infomix në bazë të re qendrore të të dhënave të platformës Oracle.
- Në gusht të vitit 2007 ka filluar realizimi i shumë aktiviteteve të lidhur me riorganizimin e rrjetit doganor nëpërmjet qasjes të përdoruesve,veçanërisht të shpediterëve tek sistemi informativ doganor. Dizajni i rri i rrjetit siguron bartje më të shpejtë dhe më të sigurt të të dhënave nga njësitë doganore. Në pjesën e teknologjisë informatike komunikative janë përpunuar dhe zbatuar aplikacionet e orientuara klient-server,ndërsa gjatë përpunimit të tyre është përdorur MS Access,MS SQL dhe MS Visual Basic for Application. Të njëjtët shërbejnë për udhëheqjen e evidencave të procedurave disiplinore,evidentimin e kallëzimeve penale dhe evidentimin e mjeteve të konfiskuara.
- Në suaza të bashkëpunimit me Drejtorinë për ndalimin e larjes së parave,Drejtoria e doganës ka filluar me përpunimin e softuerit për këmbimin e të dhënave për parat e huaja efektive gjatë hyrjes përkatësisht daljes nga Republika e Maqedonisë.

Përreth aktiviteteve e përmendura më parë në këtë fushë,në rrjedh janë edhe përgatitjet e suftvereve dhe organizimin për përmbledhjen,ndjekjen dhe analizimin elektronik të a) arkëtimin e të dhënave importuese,b) të dhënat kuantitative për punën e shërbimeve doganore në kalimet kufitare dhe në njësitë e brendshme organizative(qarkullimin e plotë dhe të zbrazët të automjeteve transportuese,veturave, personave fizik,kontrollet e kryera detale,kundërvajtjet e caktuara etj);c) të dhënat kuantitative dhe shkrimet fotografike dhe video të mallit të konfiskuar dhe statusit procedural;d) lidhjen me bazat e të dhënave për ngritjen e procedurave penale,kundërvajtës dhe disiplinore kundër personave vendas dhe të huaj,si një nga bazat për analizimin e rrezikut.

Me qëllim rritjen e efikasitetit në zbatimin e furnizimeve,në fillim të vitit 2007 Drejtoria e doganës ka sjell urdhëresë për kryerjen e furnizimeve të vogla.

Transparenca

Në vitin 2007 në maj në faqen e internetit të Drejtorisë së doganës është futur një pjesë në të cilën shpallen propozimet për drejtime dhe urdhëresa të reja,me qëllim që të mundësohet që opinioni më i gjerë të jap mendimin e vetë para sjelljes së urdhrave me të cilat më detal rregullohet mënyra e zbatimit e formaliteteve doganore.
Në të njëjtin muaj Drejtoria e doganës e ka vendosur në funksion pjesën shqiptare nga faqja e internetit të Drejtorisë së doganës,ku janë definuar mënyrat e publikimit të përmbajtjeve,veçanërisht në pjesën e legjislaturës doganore. Me këtë përmbajtjet e faqes së internetit të Drejtorisë së doganës u bënë publike edhe në gjuhën shqipe.

Për rritjen e transparencës së brendshme në punë,në vitin 2007 është punuar dhe promovuar internet portali i Drejtorisë së doganës,kua ka filluar të shpallen të dhënat dhe informatat nga karakteri intern.

Me qëllim që të lehtësohet zbatimi i procedurave doganore si për doganierët ashtu edhe për pjesëmarrësit tjerë në tregtinë ndërkombëtare,për përcaktimin e drejtë e të dhënave doganore dhe zbatimin e masave jo tarifore,Drejtoria e doganës ka përgatitur udhëheqës për doganimin e mallit për vitin 2008 në të cilën është integruar Ligji për tarifa doganore,vendimi për ndërrimin dhe plotësimin e tarifës doganore,vendimi për forma të eksportit dhe importit,shkallët preferenciale doganore në pajtim me marrëveshjet për tregti të lirë dhe masat tjera jo tarifore. Udhëheqësi është i hapur pa pagesë në faqen e internetit të Drejtorisë së doganës.

Në pajtim me masat e Qeverisë së Republikë së Maqedonisë për rritjen e transparencës dhe institucioneve publike,Drejtoria e doganës ka përgatitur ditarin e qytetarëve në të cilin janë përshkruar të gjitha shërbimet,mënyrën e marrjes ës tyre dhe personat për kontakt nga Drejtoria e doganës ,i cili duhet të shpallet në WEB faqen si shërbime të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

LEHTËSIMI I TREGTISË

Me qëllim njohjen e vështirësive dhe gjetjes së zgjidhjes për lehtësimin e tregtisë,Drejtoria e doganës në vitin 2007 në mënyrë intensive ka komunikuar me bashkësinë e biznesit dhe e ka konsultuar para sjelljes të çfarëdo vendimi sistematik në kompetenca të Drejtorisë së doganës.

Në mbledhjet e rregullta të komitetit doganor-shpeditues (në nivel shtetëror dhe regjional) dhe me odat ekonomike janë shqyrtuar propozimet për tejkalimin e gjendjeve të caktuara dhe çështjeve të hapura,siç janë vazhdimi i kohës së punës në njësitë doganore,unifikimi i procedurave doganore,mundësia e zgjerimit për doganimin e automjeteve transportuese dhe mallit teknik,zvogëlimi i shpenzimeve gjatë punës,përmirësimi i administrimit të garancive bankare,përshpejtimi i procedurës së doganimit,përmirësimi i informimit etj. Të rregullta kanë qenë edhe

kontaktet bilaterale me bashkësinë e biznesit,ndërsa rregullisht janë përgjigjur në pyetjet e parashtruara nëpërmjet faqes së internetit të drejtorisë së doganës,pyetjeve në mënyrë të shkruar dhe telefonike,ndërsa kanë qenë të organizuara edhe prezantime edhe konferenca.

Në gjysmën e parë të vitit 2007 Drejtoria e doganës në pajtim me Ligjin doganor ka sjell program dhe ka organizuar trajnime dhe dhënien e provimit profesional për kryerjen e punës të përfaqësimit në punët doganore. Provimin profesional e kanë dhënë 38 kandidatë dhe iu është dhënë licenca.

Në lidhje me rekomandimet nga Komisioni Evropian,në fund të vitit 2006 në kalimin kufitar Tabanoc me shërbimin doganor të Serbisë është realizuar projekti "Laufzettel"për matjen e kohëzgjatjes të procedurave për kalimin e kufijve. Në vitin 2007 projekte të tilla janë realizuar edhe me shërbimin doganor të Greqisë në kalimin kufitar Bogorodicë dhe shërbimin doganor të UNMIKU-ut në kalimin kufitar Bllacë. Rezultatet nga matjet e realizuara në vendet globale të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen,nuk japin drejtime konkrete operative për eliminimin e mangësive. Është e nevojshme një matje tjetër të re.

Në korrik të vitit 2007 Drejtoria e doganës në bashkëpunim dhe financim nga ana e agjencionit për tregti dhe zhvillim të SHBA,ka filluar me pilot projektin për realizimin e sistemit të vetëm regjional informatikë për shërbimet doganore të Maqedonisë,Serbisë dhe të Bullgarisë për këmbimin e informatave,për qarkullimin lehtë të mallit nëpërmjet kalimeve kufitare të caktuar. Në pilot projektin parashihet pjesëmarrje e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,odat ekonomike dhe shërbime tjera kompetente të cilat janë të pranishme në kalimet kufitare të shteteve të cilat janë pjesëmarrës në projektin.

Me qëllim lehtësimin dhe thjeshtëzimin e formaliteteve doganore dhe Korridorin 8 (Mezzogiorno-Balkan Area Customs Project) është nënshkruar Memorandum për mirëkuptim ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë për zhvillimin ekonomik të Republikës së Italisë (në projektin janë përfshirë Shqipëria dhe Bullgaria). Realizimi është në rrjedhë.

Në fund të vitit 2007 ka filluar realizimi i projektit të dytë për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Evropën Juglindore-TTFSE II,ndërmjet bankës Botërore dhe Republikës së Maqedonisë. Me projektin është paraparë përmirësimi i terminalit në kalimin kufitar Bllacë,nëpërmjet largimit të ndërtesave të përkohshme dhe ndërtimin e ndërtesave të qëndrueshme,si dhe nëpërmjet ndërtimit të lentave udhëtuese plotësuese. Përreth asaj është paraparë edhe përmirësimi i sistemit për telekomunikacion të rrugëve hekurudhore të trans korridorit të 10 evropian dhe futjen e softuerit kompatibil për përpunimin e dërgesave hekurudhave ngarkuese për hekurudha dhe dogana,duke përfshirë instalimin e sistemit hekurudhor për komunikim dhe zgjedhje për këmbimin elektronik të të dhënave me të cilat miratohet softueri për përpunimin e të dhënave ndërmjet Drejtorisë së doganës dhe Hekurudhave të Maqedonisë,mbindërtimi i kompjuterit harduer dhe softuer për e teknologjisë informatike në doganat deh hekurudhat.

Në vitin 2007 Drejtoria e doganës u ka dhënë leje 22 kompanive për kryerjen e punëve të përfaqësimit në punët doganore. Njëkohësisht 20 mbajtës të këtij lejimi janë paralajmëruar për qasjen jo adekuate gjatë kryerjes së punëve të përfaqësimit. Në pajtim me detyrimet Ligjore,Drejtoria e doganës në fund të vitit 2007 ka formuar komision për vendosjen sipas propozimeve për marrjen e licencave dhe lejeve për kryerjen e punëve të përfaqësimit në punët doganore. Aktivitetet e këtij komisioni pritet të marrin intensitet në vitin 2008.

Nën kompetencat e Drejtorisë së doganës është e lëshimi i lejeve për procedurat me efekt ekonomik,import për fisnikërim,deponim doganor,import i përkohshëm,përpunimi nën kontrollin doganor dhe eksport për fisnikërim.

Pas 250 lejeve për import për fisnikërim me sistem të arkëtimit të shtyre të të dhënave të lëshuar në vitin 2006,në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka dhënë 226 leje të reja për import. Njëkohësisht në vitin 2007 janë dhënë 6 (në krahasim me vitin 2007 ku janë dhënë 15) leje për import për fisnikërim me sistem për kthimin e të dhënave,6 leje për eksport për fisnikërim (në krahasim me 2 në vitin 2006),një leje për përpunimin nën kontrollin doganor dhe 12 leje për deponimin doganor (në krahasim me vitin 2006 ku janë dhënë 55).

Në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka vazhduar me lëshimin e lejeve për procedurat e thjeshtëzuara,ku janë lëshuar 8 leje për pranues të autorizuar (në krahasim me vitin 2006 ku janë lëshuar 6),27 leje për doganim lokal dhe 14 leje për deklarimin e thjeshtëzuar.

Shërbimet e Drejtorisë së doganës për mbikëqyrje të mbajtësve të lejeve nga llojet përmendura më parë në vitin 2007 kanë kryer 316 kontrolle tek mbajtësit e lejeve për import të fisnikërimit dhe magazinimit doganor,ku janë përgatitur 199 procesverbale për kundërvajtje doganore nga të cilat në 50 raste janë shqiptuar dënime kundërvajtës. Për parregullsitë e konstatuara në katër raste është shqiptuar masa marrje të lejeve për import për fisnikërim dhe në 2 raste marrje të lejeve për magazinim doganor.

Në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka dhënë 99 informata të detyrueshme tarifore,i cili numër në krahasime vitin 2006 është rritur dyfish kur janë lëshuar 43 IDT. Një numër i madh i IDT janë lëshuar për pajisje kompjuterike (për shkak zvogëlimit të përqindjes të TVSH tek prodhimet e caktuara),për përdorimin e veturave speciale,si dhe për lëngje dhe koncentratet e lëngjeve për prodhimin industrial (për shkak dallimit në përqindjet doganore).

Në fund të vitit 2007 është dhënë leja e parë për eksportuesin e lejuar me të cilën leje eksportuesit mund ti shfrytëzojnë përshtatshmëritë nga procedurat e thjeshtëzuara gjatë eksportit. Me këtë leje eksportuesi mund që në faturën ta deklaron prejardhjen edhe për dërgesat me vlerë më të madhe se 6.000,00 euro,në vend që të kërkon ti jepet leje për qarkullim EUR1.

Në vitin 2007 në bazë të Ligjit për mjedisin jetësor është futur kompensim i cili paguhet gjatë importit të prodhimeve për shpenzime më të gjëra të cilat janë paketuar në ambalazh plastike me qëllim destimulimin e përdorimit të këtij lloji të ambalazhit.

Sipas protokollit Montreal në vitin 2007 është sjell ndalimi i importit të frigoriferëve të përdorur ose mjeteve tjera për ftohjen dhe ngrirjen të cilat përmbajnë substanca të cilët e varfërojnë paketimin ozonik. Në vitin 2007 janë kryer 234 hulumtime laboratorike,përkatësisht 100 hulumtime më shumë se viti 2006 ku janë kryer 134 hulumtime laboratorike. Analizat laboratorike kryhen në laboratorit dhe institutet përkatëse në Republikën e Maqedonisë dhe në laboratorit e huaja doganore. Më së shpeshti lëndë e analizave janë mallrat akcizë nga industria petrokimie,industria kimike,prodhimet e ëmbla,sallo dhe vaj dhe përzierjet e tyre,etj.

Në vitin 2007 janë proceduar gjithsejtë 420,08 mijë deklarata doganore,ku për 11,89 %është më shumë se viti 2006. Në suaza të deklaratave doganore procedurale janë përpunuar 24894 mijë deklarata importuese doganore,ku për 17,87% më shumë në raport me vitin 2006 kur janë proceduar 21102 mijë deklarata importuese doganore. Në vitin 2007 janë proceduar 17114 mijë deklarata eksportuese doganore,ku për 4,09%më shumë se viti 2006.

| Gjithsejtë deklaratat e përpunuara doganore | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Dogana | 2007 | | 2006 | | 2007/2006 |
| | DVD në 000 | % | DID në 000 | % | % |
| Shkup | 219,56 | 52,27 | 196,70 | 52,39 | 111,62 |
| Kumanovë | 28,68 | 6,83 | 27,35 | 7,28 | 104,68 |
| Shtip | 55,53 | 13,22 | 50,73 | 13,51 | 109,46 |
| Gjevgjeli | 79,51 | 18,93 | 64,50 | 17,18 | 123,27 |
| Manastir | 36,80 | 8,76 | 36,15 | 9,63 | 101,80 |
| Gjithsejtë | 420,08 | | 375,43 | | 111,89 |

Pjesëmarrje dominante në deklaratat e proceduara doganore ka dogana e Shkupit me 52,27%,në të cilën vijojnë dogana e Gjevgjelisë me 18,93%,dogana e Shtipit me 13,22%,dogana e Manastirit me 8,78% dhe dogana e Kumanovës me 6,83%.

Dogana e Shkupit dominon edhe në doganimin e importit me 58,85% në përpunimin e përgjithshëm të deklaratave importuese doganore,të cilat pastaj vijojnë Dogana e Gjevgjelisë me 14,99% dhe Dogana e Shtipit me 12,07%. Dominimi i Doganës së Shkupit më pakë është shprehur në doganim eksportin (45,61%nga deklaratat e përpunuar eksportuese doganore),vijon Dogana e Gjevgjelisë me 24,65% dhe Dogana e Shtipit me 14,89%.

| Deklaratat e përpunuara importuese doganore | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Dogana | 2007 | | 206 | | 2007/2006 |
| | DID në 000 | % | DID në 000 | % | % |
| Shkup | 141,51 | 58,85 | 117,67 | 55,76 | 120,26 |
| Kumanovë | 20,71 | 8,32 | 19,02 | 9,01 | 108,89 |
| Shtip | 30,04 | 12,07 | 27,27 | 12,92 | 110,16 |
| Gjevgjeli | 37,32 | 14,99 | 29,72 | 14,08 | 125,57 |
| Manastir | 19,36 | 7,78 | 17,34 | 8,22 | 111,65 |
| Gjithsejtë | 248,94 | | 211,02 | | 117,97 |

| DVD i përpunuar sipas llojit të transportit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| transporti | 2007 | | 2006 | | 2007/2006 |
| | DID në 000 | % | DID në 000 | % | % |
| Transporti Rrugor | 380,02 | 90,46 | 339,28 | 90,37 | 112,01 |
| Transporti hekurrudhor | 18,41 | 4,38 | 17,68 | 4,71 | 104,13 |
| Transporti ajror | 19,55 | 4,65 | 16,25 | 4,33 | 120,31 |
| Transporti postar | 2,10 | 0,50 | 2,22 | 0,59 | 94,59 |
| Gjithsejtë | 420,08 | | 375,43 | | 111,89 |

Në vitin 2007 importi dhe eksporti në transportin rrugor me 90,48% nga deklaratat përpunuara doganore e ka mbajtur dominimin e njëjtë. Ndryshimet e parëndësishme në përpunimin e deklaratave as në hekurudhat,postat dhe aviotransportin.

Në korniza të bashkëpunimit ndërkombëtar doganor,Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka dërguar 153 kërkesa për kontrollin e vlerës së faturave dhe 220 kërkesa për kontrollin e dëshmive për prejardhje. Në vitin 2006 janë dërguar 83 kërkesa për kontrollin e vlerave të faturave dhe 217 kërkesa për kontrollin e dëshmive për prejardhje.

Në vitin 2007 kufijtë e Republikës së Maqedonisë i kanë kaluar 550 mijë automjete transportuese,ku në raport me vitin 2006 për 11%është më shumë ku kanë kaluar 496 mijë automjetet transportuese.

Në strukturën e përgjithshme të importit në vitin 2007 pjesëmarrje më të madhe kanë prodhimet në vijim :nafta e papërpunuar,mineral të nikel,thëngjill guri,xeherore mangani,thëngjill i zeshkët,vaj natyror,sheqer të bardh dhe sheqer të papërpunuar për rafinim,miell prej gruri,ndërsa gjatë eksportit pjesëmarrje më të madhe kanë:portland çimentoja,pllaka prej gips kartoni,nikel fero,molla,gypa,tulla muratori,vaj gazi,xehe zinku dhe koncentrati,lëngje,shalqinj,fero salikon mangan dhe xehe plumbi.

ZBATIMI I LIGJEVE

Kontrollet doganore kryhen në bazë të përmbledhjes së informacioneve,klasifikimin e tyre,përpunimin dhe analizimin për të ardhur deri tek informatat operative apo strategjike,sipas të cilës më tutje ndërmerren aktivitetet për hetim dhe zbulimin e veprimeve jolegale.

Në vitin 2007 ka vazhduar përparimi i sistemit të analizës të rrezikut dhe përgatitjes së kritereve për renditje sipas importuesit,eksportuesit,llojit të mallit,vlerës,mjetit transportues etj. Gjithashtu është zhvilluar edhe profili i rrezikut për kontrabandë të drogave i cili zbatohet në kalimet kufitare. Përparimi i sistemit të renditjes është zhvilluar edhe nëpërmjet revidimit të kritereve ekzistuese për mallra në njësitë

doganore. Në fillim të vitit 2007 është zhvilluar profili i rrezikut për shkeljen e të drejtës të pronësisë intelektuale për kalimet kufitare. Është përpunuar dhe zbatuar kriter për shkelje të së drejtës të pronësisë intelektuale dhe për njësitë e mallrave në bazë të vendit të prejardhjes,firmës importuese dhe shenjës tarifore për mallrat e falsifikuara të deritanishme.

Në vitin 2007 është përpunuar kërkues të lajmeve nga mediet. Për kërkuesin është përdorur softuer nëpërmjet të cilit në momentin e shpalljes në ueb faqen e medieve merren të gjitha lajmet. Në këtë mënyrë Drejtoria e doganës i merr të gjitha informatat relevante të shpallura në kohë reale në mediet vendase,regjionale dhe botërore.

Linja e hapur telefonike (197) është një nga mënyrat e përmbledhjes së informatave për parregullsi të ndryshme. E njëjta bie në rendin e sistemeve të përmirësuara ku çdo thirrje regjistrohet dhe incizohet. Në vitin 2007 janë regjistruar afër 80.000 thirrje në përqindje afër 219 në ditë,nga të cilat 421 me përmbajtje të dobishme. Nga këto 421 thirrje,për 51 ka qenë e nevojshme aksioni i shpejtë nga ana e njësisë doganore kompetente ose nga ekipet mobile dhe për të cilat janë marrë aktivitete të shpejta. Për 80 thirrje ka qenë e nevojshme para ndërmarrjes së aksionit hetim i mëtutjeshëm nga ana e reparteve tjera në Sektorin për hetim dhe kontroll,32 thirrje kanë qenë lëvdata dhe sugjerime nga qytetarët,ndërsa 290 thirrje kanë të bëjnë me ankesat për punën korruptive dhe jo profesionale të doganierëve.

Numri i paraqitjeve të kontrabandës arrin në 131 dhe shënon rrënje të vogël prej 10% i cili parësor ka të bëjë me zvogëlimin e numrit të paraqitjeve për kontrabandë nga kufiri me Bullgarinë,përkatësisht futjes së regjimit të vizës. Përqindja e konfiskimeve të realizuara nga thirrjet për paraqitjen e kontrabandës arrin 17% i cili është rritje prej 2% në krahasim me vitin e kaluar. Një numër i caktuar i thirrjeve akoma janë nën përpunimin operativ dhe pritet aksion i mëtutjeshëm. Në pjesën e paraqitjeve për korrupsion dhe sjelljes joprofesionale ka një numër të madh të paraqitjeve dhe një pjesë prej tyre kanë përfunduar me masa disiplinore.

Pjesë nga aktivitete e informimit është edhe vendosja e bashkëpunimit me organet tjera dhe agjencitë në Republikën e Maqedonisë siç janë Qendra kujdestarie për gjendje pranë entit për siguri publike të MPB dhe policia qarkulluese. Në shikim të bashkëpunimit me MPB,më saktësisht me policinë kufitare,në vitin 2007 janë dërguar 510 kërkesa për kontroll dhe në krahasim me vitin 2006 kur janë dërguar 157 kërkesa,intensiteti i bashkëpunimit ka shënuar nivel të rritjes trefishor.

Drejtoria e doganës në vitin 2007 maksimalisht i mobilizon kapacitete për detektim të burimeve radioaktive. Në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka detektuar 9 raste të nivelit të rritjes së rrezatimit radioaktiv,nga të cilat në 5 raste ka pasur rrezik në shëndetit e njerëzve dhe rrethinës,dhe në koordinim me Drejtorinë për siguri radioaktive janë ndërmarr masat për largimin e pasojave të dëmshme. Për shkak rritjes së sigurisë dhe regjistrimin me



kohë të burimeve radioaktive gjatë hyrjes,në kalimin kufitar Bllacë është montuar detektor panel për detektimin e rrezatimit jonit.

Në vitin 2007 është furnizuar sistem për bartjen e porosive informuese për përdorim të brendshëm (SEMS) dhe ka filluar testimi i tij. Sistemi është instaluar në kalimet kufitare Deve Bair,Tabanoc-autostradë,Aeroport Shkup dhe në repartin për koordinim dhe komunikim.

Në vitin 2007 është siguruar përkrahje IT të rëndësishme të aktiviteteve për ndalimin e tregtisë jolegale:

- është futur Borderi sistem për aktivitetet transite,
- është rivendosur baza elektronike informuese të të dhënave,
- është rivendosur baza për evidentimin e hyrjes dhe daljes të automjeteve transportues,

është vendosur SEMS-sistemi për porosi në Evropën Juglindore i cili softuer është dizajnuar me qëllim që të përdoret për të dhënat regjionale informuese doganore (në momentin i njëjti është në test fazë për përdorimin në nivel nacional).

- është vendosur sistemi-Miser me të cilin udhëheqësit kanë kontroll mbi kryerësit në nivel lokal

Në vitin 2007 Drejtoria e doganës i ka koordinuar dhe organizuar në nivel nacional operacionet SHADOW 2 në ndjekjen e transporteve me cigare,ushtrime për dërgesa të kontrolluara të drogës,operacionet ndërkombëtare LOGO në luftën kundër tregtisë me droga sintetike,operacioni ATAMAN në luftën kundër tregtisë me drogë në dërgesa postare dhe CONTAIMENT 6 në luftën kundër tregtisë me heroin.

Gjatë zbatimit të kontrolleve,doganierët i përdorin pajisjet dhe allatet tjera të fituara si donacion nga kancelaria për ndihmë doganore dhe fiskale të Maqedonisë (CAFAO-MAK),të financuar nga Unioni Evropian nëpërmjet programit CARDS,nga Qeveria e SHBA, dhe nga donatorët tjerë bilateral. Nga të dhënat e lartpërmendura qartë shihet se me përdorimin e këtyre pajisjeve bashkëkohore përmirësohet edhe efikasiteti gjatë zbatimit të kontrolleve.

Në aktivitete e saja për ndalimin e tregtisë jolegale,Drejtoria e doganës ngushtë bashkëpunon me policinë kufitare,MPB,policinë financiare,Drejtorinë për ndalimin larjes së parave,Drejtorinë e të hyrave publike,Drejtorinë për ushqim,dhe Drejtorinë për siguri radioaktive.

Në vitin 2007 janë realizuar trajnime speciale të cilat janë në funksion të përmirësimit të kapacitetit për prirjen me krimin e organizuar:

- metodat e zbatimit dhe arrestimin e personave,
- falsifikimin e dokumenteve të realizuara në akademinë policore,
- bazat e kontabilitetit,
- trajnimi për krimin e organizuar dhe korrupsionin,të realizuar në Akademinë për prokuror publik dhe gjykatës,
- trajnime për transport të kontejnerëve,dhe siguria e transportit të kontejnerëve-bashkëpunimi ndërkufitar në shkatërrimin e tregtisë me njerëz,kontrabandës të migruesve dhe drogës,
- trajnim për sigurinë gjatë kryerjes së kontrollit,
- trajnim për ndjekje të fshehtë,
- trajnim për përdorimin e automjeteve mobil rëntgen dhe skenim,
- trajnim për zbulimin e drogës dhe substancave psikotropike,
- trajnim për proliferimin e armëve për shkatërrimin masovik.

Posaçërisht aktive në këtë periudhë kanë qenë shërbimet regjionale për mbikëqyrje të poseduesve të lejeve me efekt ekonomik. Përreth aktiviteteve për dhënien e lejeve,këto shërbime u kanë kryer kontroll poseduesve të lejeve për mbajtjen depove publike doganore,ku kanë konstatuar një numër të madh të parregullsive dhe janë ngritur kallëzime kundërvajtës,është bërë arkëtimi e borxhit

doganor për mallin doganor e cila edhe pse ka dashur nuk ka qenë në depot publike doganore,ndërsa njërit posedues të lejeve i njëjta iu është marrë. Në këtë periudhë është marrë edhe një leje për import për fisnikërim.

Me qëllim sigurimin e logjistikës ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare në aktivitete për ndalimin e tregtisë jolegale,Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka vendosur dhe e ka përparuar bashkëpunimin me shumë institucione vendase dhe të huaj:

- Memorandum për bashkëpunim me policinë Financiare,
- Protokoll për bashkëpunim në ndalimin e krimit të organizuar në Republikën e Maqedonisë,DHP,policisë financiare,Drejtoria për ndalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit,
- Memorandum për bashkëpunim në zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve të veprave penale nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit me Prokurorinë publike,MPB,DHP,policinë financiare,dhe Drejtorinë e ndalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,

> Me 22 dhe 23 nëntor 2007 nën Organizimin e Drejtorisë së doganës në Ohër,është mbajtur konferenca e tretë regjionale të shërbimeve për kontroll dhe hetim ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga Drejtoria e doganës të Shqipërisë,Maqedonisë,Serbisë,Sllovenisë,Kroacisë, dhe UNMIKU-ut,si dhe përfaqësues nga MISIONI KAFAO-MAK në Republikën e Maqedonisë. Në konferencën kanë marrë pjesë me prezantimet dhe përfaqësuesit e vetë dy kompani duhani Imperial Tobacco dhe British dhe American Tobacco. Qëllimi konferencës ka qenë thellimi i bashkëpunimit dhe këmbimi i të dhënave në nivel regjional si parakusht për përforcimin e luftës kundër kontrabandës të mallrave dh krimit të organizuar në regjion.

- Memorandum për bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor,
- Memorandum për bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë-Drejtoria për ushqim,
- Memorandum për bashkëpunim me Drejtorinë për siguri radioaktive,
- Memorandum për mirëkuptim me Ministrinë e Bujqësisë,pylltarisë dhe ujësjellësit,
- Memorandum për bashkëpunim me NP për shërbime të aeroporteve,
- Memorandum për bashkëpunim me aviotransportin Maqedonas,
- Memorandum për bashkëpunim me Croatia Airlines,
- Memorandum për bashkëpunim me prodhuesit dhe distributorët e duhanit siç janë: Kombinati i duhanit Shkup i cili është anëtar në grupacionin Imperial Tabaco Grup,Japan Tabacco International,British AmericanTobacco,
- Marrëveshje për bashkëpunim doganor ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovakisë,
- Marrëveshje për bashkëpunim për punët doganore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës,
- Është intensifikuar bashkëpunimi me SEKI veçanërisht në pjesën e pjesëmarrjes në të gjitha operacionet ndërkombëtare dhe këmbimi i informatave për konfiskime si dhe informata tjera informuese,
- Është intensifikuar bashkëpunimi me RILO në korniza të Organizatës doganore Botërore për futjen e të dhënave në CEN bazën e të dhënave siç janë 260 lëndë për konfiskime të devizave në vitin 2007 dhe 60 lëndë në vitin 2006. Në bazë të kutive shënimeve Republika e Maqedonisë është në vendin e shtatë në botë në numrin e konfiskimeve të devizave në pajtim me raportin e fundit të SEZAM Rilo. Ka filluar përdorimi aktiv i bazës së të dhënave CEN

për shkak përcaktimeve trendëve të rrezikshme,ku është përpunuar raporti informues strategjik për droga,

- Është vendosur bashkëpunimi me ZKA Ballkan Info për këmbimin e të dhënave për konfiskimin e drogave dhe të dhënave potenciale për kontrabandë të drogës,
- Është vendosur sistem për marrjen automatike e të dhënave nga regjistri qendror për persona juridik si dhe nga depozitimi qendror-të dhënat për pagesë të cilat i ndërmerr softueri për arkëtim,
- Në fazën përfundimtare është projekti me Drejtorinë për ndalimin e larje së parave për fitimin e të dhënave në automatizëm për hyrje dhe dalje të devizave,arit monetar,kundërvajtjeve revizore, si dhe procedurave importuese-eksportuese,është siguruar qasje të kufizuar deri tek baza e të dhënave për persona juridik të DHP,
- Është vendosur këmbimi i informatave me qendrën kujdestarie për gjendje të MPB në bazë ditore,ndërsa marrja e të dhënave nga policia kufitare matet me orë,
- Është vendosur bashkëpunimi dhe mbledhje të rregullta me Entin për barna dhe Prokurorët publikë.

Aktivitete dhe masat për forcimin e kapacitetit dhe angazhimit intensiv të Drejtorisë së doganës ka rezultuar me një sasi të madhe të konfiskimit të mallrave dhe kallëzimeve penale dhe kundërvajtës.

Narkotiket

549,15 kilogram narkotik,nga të cilat

***486,7 kilogram kokainë,të konfiskuar në kalimin kufitar Bllacë të fshehura në kantonier me ngjyrë në kamion me targa regjistrimi të Maqedonisë i cili ishte transit nëpërmjet RM për në Greqi***




***46,65 kg heroinë,nga të cilat4,65 kg janë konfiskuar në kalimin kufitar Bogorodicë me Greqinë,9,5 kg në autobus transportues në kalimi kufitar Dellçevë me Bullgarinë dhe 32,5 kg në automjet transportues në kalimin kufitar Deve Bair***



***15,8 kg mariuhanë janë konfiskuar në një aksion të përbashkët me policinë e cila ishte fshehur në veturë,nj sasi e vogël në dërgesë DHL***




**Armë**

*95 copë revole dhe pushka dhe 29.110 copë municion*



## Mallra akcizë

*21,7 milion cigare,si dhe një sasi të vogël të purove,duhan i përpunuar vendas*




*1.600 litra pije alkoolike*

*37,5 tonë lëndë djegëse disel dhe vaj motorik*




## Para të huaja në kesh

*900.000 euro në valuta të huaja*




**Barna dhe materiale mjekësore**

*11.959 copë barna të ndryshme*
*102.000 copë ndihma kirurgjike*
*137.000 copë hazaplast*
*1.350 copë teste për matjen e sheqerit në gjak*
*3.000 copë vijagra*
*6.195 shishe vaj për si mjete ndihmëse mjekësore*




**Prodhime Bujqësore dhe ushqimore**

*30.000 kg mish lope të ngrirë*
*25.000 kg kompot*
*23.500 kg qepë*
*19.000 kg herbicide dhe 470 kg pesticide*
*2.300 kg mish të thatë*
*4.620 copë fidan*
*1.635 pako lule të krasitura*
*Sasi të ndryshme çaji,erëza,peshk i ngrirë,nes kafe*
*Mallra të gjallë(55 mështjerra dhe 6 viça),152 zogj ekzotikë,bleta etj.*



**Mallra tjerë**

*475.300 copë veshje*
*201.520 copë preparate kozmetike*
*120.000 mallra teknik ( allat elektrik,makina të ndryshme aparate për amvisëri etj)*
*690 kg çimentë*
*384 copë ngjyrë dhe llak për këpucë*
*17.347 kg ngjitëse*
*535 filma për fotografi*
*65.000 qese najlloni*
*4.623 copë takëme për kuzhina*
*741 copë zorra prej gome*
*320 м² llamperi dhe parket*
*73.000 këpucë ,*
*60.000 copë parfume dhe ujë tualeti*
*89.000 pjesë për celularë*
*2.800 copë goma për vetura dhe kamion*



*5.960 gr ari*
*330 gr argjend*
*13.777 copë bizhuteri të ndryshme dhe imitim të stolive*
*45 copë ikona*
*1.200 tonë xehe mangani*
*184 tona koks*




Në vitin 2007 Drejtoria e doganës ka shpallur 5 lecitaci publike dhe 5 shitje në rrugë të përmbledhjes së ofertave të mallit e cila është konfiskuar ose hequr dorë në dobi të shtetit. Një pjesë më e madhe e mallrave të shitura janë veshjet dhe makinat për prodhimin industrial.

Në të njëjtën periudhë Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjell 62 vendime për shmangien e mallit të konfiskuar në organet shtetërore dhe organizatave humanitare,para së gjithash veshje ,këpucë,mall teknik etj.

Mallrat të cilat nuk mund të shiten asgjësohen në pajtim me dispozitat doganore. Në vitin 2007 janë asgjësuar 20 milion copë cigare,60 copë granata,1300 litra pije alkoolike dhe 3700 kg mall të ndryshëm(kozmetikë,ushqim,barna me afat të skadimit të përdorimit).

Drejtoria e doganës në vitin 2007 deri tek Prokuroria publike ka parashtruar 167 kallëzime për bërjen e veprave penale (në vitin 2006 janë parashtruar 69 kallëzime)kundër 70 personave juridik (28 në vitin 2006)dhe 146 kundër personave fizik (130 në vitin 2006 )nga të cilat :

| | | |
|---|---|---|
| Shmangie nga tatimet | 7 | 10 |
| Mashtrim doganor | 19 | 53 |
| Kontrabandë | 16 | 34 |
| Falsifikimi i dokumenteve | 3 | 6 |
| Përdorimi i dokumenteve me përmbajtje të rrejshme | | 1 |
| Kontrabandë të mallrave akcizë | 25 | 57 |
| Prodhime të paautorizuara dhe lëshimi në qarkullim i drogave | 6 | 3 |
| Përpunimi i paautorizuar,mbajtja dhe tregtia me armë | 2 | 1 |
| Tregtia e palejuar | | 2 |
| Prodhime të paautorizuara dhe qarkullimi me materie të rrezikshme | 6 | |
| Ndalimi i personit zyrtare në kryerjen e veprimeve zyrtare | 1 | |
| Transporti i mallrave akcizë nga depot akcize | 1 | |

Për veprat penale të lartpërmendura vlera e të dhënave doganore të ikura arrin 107,7 milion denarë (288,2 milion denarë në vitin 2006,nga të cilat vetëm në një rast në dhjetor 2006,rreth 270 milion denarë).

Pjesa integruese nga sektori për kontroll dhe hetim është shërbimi për ekip mobil i cili aktiviteti kryesor është lufta kundër krimit të organizuar. Selia e këtyre ekipeve është në Shkup,por ato e përfshijnë tërë territorin doganor e Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2007 nga ana e ekipeve mobile janë kryer kontrolle detale të 4391 automjeteve transportuese (në krahasim me vitin 2006 1119) dhe 633 kontrolle të autobusëve (672 në 2006) dhe 6378 automobilave (1901 në 2006).

Në pajtim me ligjin për kundërvajtje dhe në bazë të themelimit të saj,ndryshimet e sjella në Ligjin për Drejtorinë e doganës në tetor 207 Drejtoria e doganës i ka ndërmarr kompetencat nga gjykata për udhëheqjen e procedurave kundërvajtës,shqiptimin e sanksioneve kundërvajtës,dhe masat e veçanta kundërvajtës për bërjen e kundërvajtjeve doganore. Qëllimi është zgjedhja më e shpejtë dhe më efikase e procedurave doganore në funksion të zvogëlimit të kundërvajtjeve doganore. Është formuar reparti për kundërvajtje –Komisioni për vendosje sipas kundërvajtjes dhe janë sjell akte interne për mënyrën dhe procedurat e organeve doganore gjatë zbulimit të kundërvajtjeve doganore dhe dhënies së thirrjes për pagimin e gjobës,si dhe formën dhe përmbajtjen e procesverbalit për kundërvajtje doganore. Në periudhën prej 01.10.2007 deri në 31.12.2007 Drejtoria e doganës ka iniciuar 754 kallëzime kundërvajtës nga të cilat:

- 116 kallëzime kundërvajtës janë parashtruar nga ana e MPB për menaxhimin joligjor të veturave me targa regjistrimi të huaja,
- 52 kallëzime kundërvajtës janë parashtruar nga ana e sektorit për kontroll dh hetim ,
- 51 kallëzime kundërvajtës janë parashtruar nga ana e njësive doganore,
- 40 kallëzime kundërvajtës nga ana e shërbimeve për mbikëqyrje të poseduesve të lejeve dhe
- 15 kundërvajtje janë kthyer në gjykatat themelore të cilët me vendim janë proklamuar jokompetent.

Deri në fund të vitit 2007 janë zgjidhur 176 lëndë,nga të cilat 40 lëndë në procedurë të shpejtë dhe 136 lëndë në procedurë të rregullt,për të cilat janë shqiptuar gjoba në shumë të përgjithshme prej 6 milion denarë.

Në vitin 2007 janë përpunuar 4.874 lëndë administrative,nga të cilat 4724 janë kryer. Nga këto lëndë 2350 janë në bazë të arkëtimit plotësues së të dhënave importuese në shumë të përgjithshme rreth 500 milion denarë.

## MBROJTJA E TË DREJTAVE NGA PRONËSIA INTELEKTUALE

Drejtoria e doganës në vitin 2007 i ka intenzivuar aktivitetet për sigurinë e zbatimit të drejtë të masave të politikës tregtare lidhur me moralin publik,sigurinë,rruajtjen e shëndetit të njerëzve,kafshëve dhe bimëve,mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës,mbrojtjen e pasurisë nacionale me vlerë artistike,historike ose arkeologjike dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale.

Disa brende të mbrojtura tek Drejtoria e doganës

L'Oreal
Dolce & Gabbana
Gianni Versace
Hugo Boss
Adidas
Dior
Diesel
Nivea
Nokia
Chanel
Puma
Reeboc
Gucci
Lacoste
Marlboro
Kenzo
Canon
Estee Lauder
Davidoff
Zippo
Epson
Sony Ericcson
Winston
Sprite
BIS

Në vazhdim të vendimeve sistematike për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale të sjella në vitin 2006,Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka përpunuar një kriter të ri për rrezik të njësive të brendshme doganore-INTEL i cili ka të bëjë me mallra të cilët shkelin të drejtat nga pronësia intelektuale. Janë përcaktuar firmat importuese tek të cilat është zbuluar mall e cila i shkel të drejtat nga pronësia intelektuale,si dhe llojin e mallit e cila është konfiskuar dhe asgjësuar. Firmat dhe shenjat tarifore janë futur në listën e IPR në modulin e seleksionimit në programin ASYCUDA. Është bërë kodi programor dhe është kryer testimi i të njëjtit në raport me deklaratat të test serverit.

Në pjesën e aktiviteteve për përforcimin e kapacitetit administrativ për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale,në bashkëpunim me Drejtorinë e doganës së Francës në janar 2007 është organizuar seminar për pronësi intelektuale.

Në janar 2007 në bashkëpunim me Asociimin e bartësve të së drejtave dhe përfaqësuesve –SNB REACT,si edhe në bashkëpunim me doganën Holandës janë mbajtur 11 prezantime të përfaqësuesve të brendeve të njohura botërore dhe shumë seminare për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale.

Më datë 26.01.2007 Drejtoria e doganës ka organizuar forum me temë Ndal falsifikimeve dhe piraterive,për arsye të shënimit të ditës botërore doganore,në të cilën janë shpërndarë tre pllakate të përfaqësuesve më aktiv.

Në fund të vitit 2007 në bashkëpunim dhe me përkrahjen financiare të Ambasadës të mbretërisë së Holandës ka filluar organizimi i kampanjës së medieve publike për njoftimin e opinionit me dëmet ekonomike,shoqërore dhe shëndetësore tek prodhuesit,distributoret, dhe përdorimin e falsifikimeve dhe piraterive,si dhe për kërkesat e përkrahjes nga opinioni për zbulimin e tentimeve për tregti me prodhime të tilla.

Drejtoria e doganës në vitin 2007 në 35 raste ka ndalur shkeljen e të drejtës nga pronësia intelektuale (46 në krahasim me vitin 2006) nga të cilat 144 raste janë paraqitur gjatë importit (28 në 2006),177 gjatë transitit (18 në 2006),3 gjatë eksportit dhe 1 në procedurë të magazinimit doganor,ku përkohësisht janë mbajtur 1,6 milion copë mallra të falsifikuara (0,07 milion në 2006) edhe atë:

*77.082 mijë copë preparate kozmetike,përkatësisht 4,8% nga konfiskimi i përgjithshëmi i mallit të falsifikuar*




*113.242 mijë parfume,ujë tualeti,dhe dezoderans,përkatësisht 7,1 nga konfiskimi i përgjithshëm i mallit të falsifikuar*




*47.316 mijë copë takëme për celularë,3% nga sekuestrimi i mallit të falsifikuar*




*249.459 mijë veshje,përkatësisht 15,4%nga konfiskimi i mallit të falsifikuar*



*3.572 mijë pajisje sportive përkatësisht*
*0,2%nga konfiskimi i mallit të falsifikuar*



*37.069 mijë këpucë sportive,përkatësisht*
*2,3% nga konfiskimi i mallit të falsifikuar*




*21.488 mijë copë syza për diell,përkatësisht*
*1,3%nga konfiskimi i mallit të falsifikuar*




*150.528 copë pastë për dhëmbë,përkatësisht*
*9,3 %nga konfiskimi i mallit të falsifikuar*



*126.286 copë pjesë për automobila përkatësisht 7,8% nga konfiskimi i mallit të falsifikuar*




*786.254 tonë mallra tjerë,përkatësisht 48,8% nga konfiskimi i përgjithshëm i mallit të falsifikuar*



Sipas dokumenteve të deklaruara,numri më i madh i mallrave të falsifikuara vjen nga Emiratet e Bashkuara Arabe (458.520 mijë copë ose 28,5% nga konfiskimet e falsifikuara),Kina (mbi 229.383 mijë copë ose 14,2% nga konfiskimet e falsifikuara),Tajvan (mbi 120.000 mijë copë ose7,4% nga konfiskimet e përgjithshme falsifikuese) dhe Turqia (75.859 mijë ose 4,7 nga konfiskimi i përgjithshëm i falsifikimeve).

Për të gjitha rastet e konfiskimit të mallit të falsifikuar Drejtoria e doganës deri tek organi inspektues kompetent dhe MPB ka dorëzuar informacione detale për falsifikimet,personat e kyçur juridik dhe fizik të huaj dhe vendas,për destinacionin fillestar dhe përfundimtar të dokumenteve,si dhe informatat dhe të dhënat relevante.

Në pajtim me Ligjin për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale,ndërsa pas procedurës së përfunduar për vërtetimin e falsifikimit dhe shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale,Drejtoria e doganës ka asistuar në zbatimin e procedurave për asgjësimin e mallit të falsifikuar. Në vitin 2007



janë asgjësuar 924.577 copë dhe 855 kilogram mall të falsifikuar.

ARKËTIMI I TË DHËNAVE IMPORTUESE




Drejtoria e doganës administron dhe paguan gjatë importit të mallit dogana,akciza dhe TVSH.

Në vitin 2007 ka vazhduar procesi i liberalizimit,në pajtim me detyrimet nga protokolli për afrimin e Republikës së Maqedonisë në organizatën tregtare botërore,për çka përqindja doganore e Republikës së Maqedonisë në vitin 2007 është zvogëluar për 1,05% dhe zvogëlimi vjetor i përqindjes doganore sipas tabelave kohore nga Marrëveshja për tregti të lirë.




Në vitin 2007 ka vazhduar zbatimi i marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe unionit Evropian ki gjithashtu ka rezultuar me zvogëlimin progresiv ose heqjen e përqindjeve doganore për një pjesë të madhe të prodhimeve industriale dhe për grup të prodhimeve bujqësore.

Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka paguar gjithsejtë 41,79 miliardë denarë në emër të të ardhurave buxhetore,ku është për 9,09 miliardë denarë ose 28%më shumë në raport me vitin 2006.




Në krahasim me të ardhurat e planifikuara për vitin 2007 të cilat sipas ribalansit të fundit të buxhetit të Republikës së Maqedonisë arrin 38,77 miliardë denarë,të ardhurat e arkëtuara janë për 11%më të mëdha.

Nga gjithsejtë të ardhurat buxhetore të paguara në emër të doganës dhe të dhënave tjera doganore në vitin 2007 janë paguar 6,4 miliardë denarë ku për 0,8 miliardë denarë ose për 14,24% është më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2006 kur janë paguar 5,6 miliardë denarë (grafika nr 3).




Në emër të TVSH Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka paguar 34,5 miliardë denarë ku për 8,1 miliardë denarë ose për 31 % është më shumë në krahasim me vitin 2006 kur janë paguar26,4 miliardë denarë (grafika nr 4).

Në emër të akcizave Drejtoria e doganës në vitin 2007 ka paguar 0,89 miliardë denarë ku për 0,21 miliardë denarë ose për 31,5% më shumë në raport me vitin 2006 kur janë paguar 0,68 miliardë denarë (grafika nr 5).




Të ardhurat të cilat i ka paguar Drejtoria e doganës kanë marrë pjesë me 41,8%në gjithsejtë të ardhurat buxhetore të paguara në vitin 2007.

Të ardhura tjera

Drejtoria e doganës përreth pagesës së doganës,akcizave,dhe TVSH gjatë importit të mallit,në vitin 2007 gjithsejtë ka paguar 67 milion denarë të ardhura personale të cilat në krahasim me vitin 2006 janë më të mëdha për 20% kur gjithsejtë janë paguar 56 milion denarë .

Në strukturën e të ardhurave personale pjesëmarrje më ta madhe kanë të ardhurat nga përdorimi i sistemit kompjuterik MAKCIS dhe të ardhurat nga puna suplementare e realizuar në ditët jo pune dhe festave me qëllim që të shpejtohet procedura e doganimit dhe të kënaqen kërkesat e pjesëmarrësve në procedurën doganore.